

Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime (SIT)

INSTITUT I AUDITIMIT TË PAVARUR

INSTITUTI I KËSHILLIMIT SHËRBIME SOCIALE

INSTITUTI I KËSHILLIMIT SHËRBIME SOCIALE

INSTITUTI I KËSHILLIMIT SHËRBIME SOCIALE

INSTITUTI I KËSHILLIMIT SHËRBIME SOCIALE

INSTITUTI I KËSHILLIMIT SHËRBIME SOCIALE

INSTITUTI I KËSHILLIMIT SHËRBIME SOCIALE

INSTITUTI I KËSHILLIMIT SHËRBIME SOCIALE

INSTITUTI I KËSHILLIMIT SHËRBIME SOCIALE

QENDRA PËR KËSHILLIM, SHËRBIME SOCIALE DHE HULUMTIME (SIT)

PASQYRAT FINANCIARE ME RAPORT TË AUDITORËVE TË PAVARUR

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

Përmbajtja

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR.....	3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E BILANCIT TË FONDEVE	7
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	8
1. Informata të Organizatës	9
2. Baza e pergatitjes	9
3. Përmbledhja e politikës së rëndësishme në kontabilitet	10
4. Paraja në bankë dhe dorë	11
5. Të arkëtueshme dhe të tjera	11
6. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera.....	11
7. Grantet dhe Donacionet	12
8. Shpenzimet Programore	12
9. Shpenzimet Administratës	13
10. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese	13



NOVAZA L.L.C.
Str. Fehmi Agani 42/1
10000 Prishtinë, Kosovë

t: +383 (0)44-993-337
w: www.novaza-ks.com
e: info@novaza-ks.com

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për: Menaxhmentin e SIT

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të SIT (Organizata), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2025 dhe pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Organizatës për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kërkesat për raportim financiar të përshkruar në shënimin 2 dhe kërkesave sipas ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me kërkesat etike që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e përftuara të auditimit janë të majftueshme dhe të përshatshme për të na ofruar një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me dispozitat e raportimit financiar të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë dhe për kontrollin e tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e organizatës, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomali mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional përgjatë tërë auditimit.


Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojmë evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontroleve.
- Përftojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimi, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përftuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Altin Sahiti
Auditor ligjor

Prishtinë, Kosovë
13 shkurt 2026



QENDRA PËR KËSHILLIM, SHËRBIME SOCIALE DHE HULUMTIME (SIT)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR


Me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në Euro)

Me 31 dhjetor		2025	2024
	<i>Shënimet</i>		
Pasuria qarkulluese			
Paraja në bankë dhe dorë	4	450	8,268
Llogaria e arkëtueshme	5	9,855	9,543
Gjithsej		10,305	17,811
Gjithsej pasuria		10,305	17,811
Detyrimet			
Llogaria e pagushme dhe të tjera	6	1,166	-
Fondet e shtyera	6	9,092	17,763
Gjithsej		10,257	17,763
Balanci i fondeve			
Saldo fillestare		48	48
Teprica/(humbja) e periudhës		-	-
Gjithsej		48	48
Gjithsej detyrimet dhe fondet		10,305	17,811

Aprovuar nga:

Kadri Gashi - Drejtor Ekzekutiv



Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 12 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

QENDRA PËR KËSHILLIM, SHËRBIME SOCIALE DHE HULUMTIME (SIT)

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në Euro)

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor		2025	2024
	<i>Shënimet</i>		
I. Të hyrat:			
Grantet dhe donacionet	7	165,045	379,598
Gjithsej (I)		165,045	379,598
II. Shpenzimet:			
Shpenzimet programore	8	(105,165)	(145,661)
Shpenzimet e administratës	9	(59,880)	(233,937)
Gjithsej shpenzime (II)		(165,045)	(379,598)
Teprica (humbja) (I-II)		-	-

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 12 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

QENDRA PËR KËSHILLIM, SHËRBIME SOCIALE DHE HULUMTIME (SIT)

PASQYRA E BILANCIT TË FONDEVE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në Euro)

	Bilanci i fondeve	Total
Gjendja me 01 janar 2025	48	48
Teprica (deficiti) I periudhës	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2025	48	48
Teprica (deficiti) I periudhës	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2025	48	48

QENDRA PËR KËSHILLIM, SHËRBIME SOCIALE DHE HULUMTIME (SIT)

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në Euro)

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2025	2024
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Teprica (humbja) neto e vitit	-	-
<i>Ndryshimet në pasuri dhe detyrime</i>		
Zhvlerësimi	-	-
Llogaria e arkëtueshme	(311)	(1,579)
Parapagimet		
Llogaria e pagueshme	1,166	-
Të hyrat e shtyra	(8,672)	646
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative	(7,817)	(933)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Investimet në paisje		
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		
Ndryshimi neto i rrjedhës së parasë	(7817)	(933)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	8,268	9,201
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	451	8,268

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 12 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

QENDRA PËR KËSHILLIM, SHËRBIME SOCIALE DHE HULUMTIME (SIT)

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në Euro)

1. Informata të Organizatës

Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime - SIT ka për mision ofrimin e shërbimeve profesionale këshilluese, hulumtime në fusha të ndryshme, si dhe parandalimin e dukurive negative me qëllim të kontribimit dhe të përmirësimit të shëndetit dhe mirëqenies sociale.

Që nga fillimi është përqëndruar në hulumtime dhe ngritje të kapaciteteve të mësimdhënësve dhe akterëve tjerë, nga viti 2018, ka ndryshuar dhe zgjeruar objektivat dhe tani punon në tri fusha, duke ofruar shërbime profesionale, këshillimin e ushtruesve të dhunës, promovimin e të drejtave të njeriut, barazinë gjinore, jetesën e shëndetshme, parandalimin e dhunës dhe parandalimin e fenomeneve negative në komunitet.

Organizata ka për qëllim të shërbej dhe të jetë në tri fusha:

- Qendër për këshillim,
- Shërbime sociale dhe
- Hulumtime.

Disa nga aktivitetet e implementuar gjate vitit 2025 janë:

- Seanca këshilluese me të miturit dhe kryerësit e dhunues në familja dhe dhe DhBGj dhe ata/ato që kanë pasur predispozita të jenë të dhunshëm;
- Promovimi i të drejtave të njeriut përmes projektive për paranalim , në shkolla te mesme dhe në universitete publike dhe private;
- Ligjerimi për barazinë gjinore përmes punëtorive në shkolla të mesme, universitete dhe gjarje te ndryshme;
- Organizimi i kampanjave të ndryshme për parandalimin e çdo lloj të dhunës në komunitet;
- Promovimi i prindërimit pozitiv dhe përfshirjen e djemve dhe burrave në barazi gjinore duke organizuar ngjarje të ndryshme, po ashtu debate per të provuara lejen prinderore dhe bashkëjetesen e shëndetshme;
- Promovimi i të drejtave seksuale dhe riprodhuese përmes rrjetit të organizatave locale në Kosovë;
- Promovimi i shëndetit mendor dhe shëndetit seksual;
- Implementimin e e programieve për parandalim e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm tek të rinjtë, përmes punëtorive, aktiviteteve dhe organizimin e kampeve verore;
- Hulumtimet e ndryshme lidhje me fushat sociale dhe ekonomike;

2. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 06/L-043 Për Lirinë e Asocimit në Organizatat Jo-qeveritare me qëllim të raportimit në Zyrën e Rregullatorit të OJQ-ve.

Të hyrat nga grantet njihen kur fitohen në vend se kur pranohen dhe shpenzimet njihen kur ndodhin në vend se kur paguhen.

Perveç kësaj, detyrimi i shtyrë i grantit, parapagimet dhe detyrimet e tjera regjistrohen sipas bazës akruale të kontabilitetit. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit janë përshkruar më poshtë.

QENDRA PËR KËSHILLIM, SHËRBIME SOCIALE DHE HULUMTIME (SIT)

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në Euro)

3. Përmbledhja e politikës së rëndësishme në kontabilitet

3.1. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paranë në arkë dhe paranë e pakushtëzuar me bankat ose depozitat me afat maturimi më pak se tre muaj.

3.2. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose për t'u arkëtuar dhe përfaqëson vetëm shumën e arkëtueshme nga donatorët në lidhje me listën e pagave, shpenzimet operative dhe shpenzimet tjera të shkaktuara.

3.3. Transaksionet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të ndryshme nga valuta funksionale (valutë të huaj) regjistrohen në normat e këmbimit që mbizotërojnë në datat e transaksioneve. Në çdo datë raportimi, zërat monetare të shprehur në valutë të huaj konvertohen në normat mbizotëruese në datën e raportimit. Zërat jo-monetarë që maten me kosto historike në valutë të huaj nuk ripërkthehen. Diferencat e këmbimit që rrjedhin nga zërat monetare, janë të përfshira në fitimin dhe humbjen e periudhës në të cilën ato lindin.

3.4. Përfitimet e punonjësve

Organizata nuk ka përgjegjësi shtesë për pensionet e punëtorëve përveç pagesës së kontributeve pensionale në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

3.5. Kontigjencat dhe provizionet

Detyrimet kontigjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen përveç nëse mundësia e rrjedhës se mjeteve që truhezojnë përfitime ekonomike është e largët. Një pasuri kontigjente nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur hyrja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Një provizion është i njohur atëherë kur Organizata ka një detyrim të pranishëm (ligjor ose strukturor) si rezultat i një ngjarje të kaluar dhe është e mundshme që një rrjedhje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohen për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund t'i bëhet shumës së detyrimit.

3.6. Gjykime kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim

Në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Organizatës, të cilat janë të përshkruara më sipër, menaxhmenti nuk ka herë asnjë gjykim i cili ka efekte të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare

QENDRA PËR KËSHILLIM, SHËRBIME SOCIALE DHE HULUMTIME (SIT)

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në Euro)

4. Paraja në bankë dhe dorë

Me 31 dhjetor	2025	2024
Paraja në bankë	374	6,827
Paraja në dorë	77	1,441
Total	450	8,268

5. Të arkëtueshme dhe të tjera

Me 31 Dhjetor	2025	2024
Parapagimet	-	551
Të arkëtueshme nga donatorët	9,855	2,415
Rimbursim për udhëtime	-	78
Tjera	-	6,500
Total	9,855	9,543

6. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

Me 31 dhjetor	2025	2024
Llogaritë e pagueshme	1,166	-
Nën-total (I)	1,166	-
<i>Tjera</i>		
Huazimet	9,050	
Fondet e shtyra	42	17,763
Nën-total (II)	9,092	17,763
Total (I+II)	10,257	17,763

QENDRA PËR KËSHILLIM, SHËRBIME SOCIALE DHE HULUMTIME (SIT)

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në Euro)

7. Grantet dhe Donacionet

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2025	2024
DOU ACT	7,497	14,970
DoYouth	-	119,844
DRC	39,138	70,534
YMI - CARE	-	7,613
Propeace	11,485	
UNFPA - Counseling for Prevention	40,874	52,354
YouthINC	12,635	
Poke the Bubble	27,285	88,828
Grante Publike	1,434	
Tjera	25,162	26,101
Nën-total (I)	165,510	380,244
<i>Tjera</i>		
Fondet e shtyera	(465)	(646)
Nën-total (II)	(465)	(646)
Total (I+II)	165,045	379,598

8. Shpenzimet Programore

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2025	2024
Shpenzime e pagave (Administratë dhe Konsulentët)	100,160	138,725
Kontributet pensionale	5,006	6,936
Total	105,165	145,661

QENDRA PËR KËSHILLIM, SHËRBIME SOCIALE DHE HULUMTIME (SIT)

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në Euro)

9. Shpenzimet Administratës

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2025	2024
Shpenzimet e organizatës partnere	7,687	137,629
Shpenzime të furnizimit	3,048	7,932
Ushqim dhe Mikepritje	5,505	12,609
Promocion	169	213
Shpenzime e internetit	1,209	2,139
Qiraja	6,672	7,226
Shpenzime të platformës		-
Shtyp dhe promovim	1,932	5,460
Shpenzimet e udhëtimit	4,755	6,042
Shpenzime për konferenca	1,140	4,608
Mirëmbajtja e pajisjeve të zyrës		-
Shpenzimet e menagjimit zyres	348	321
Shpenzime të përkthimit		5,250
Shpenzime të telefonit	1,118	797
Konsulencë	3,400	1,790
Shpenzimet e bankës	380	471
Shpenzime te trajnimit	794	249
Shpenzimet e antarësimit	1,894	75
Shpenzime te aktiviteve	18,389	41,097
Tjera	1,440	31
Total	59,880	233,937

10. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese

Nuk ka ngjarje që pasojnë datën e raportimit që kërkojnë dhënie të informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare të Organizatës.